



Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve

Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve

**Analizë mbi përdorimin e monedhës kombëtare në tregjet
financiare, nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Mbikëqyrjes
Financiare**

Mars 2023

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
I. Hyrje.....	3
II. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve.....	4
A. Tregu i sigurimeve.....	4
1. Informacion mbi primet e shkruara bruto.....	4
2. Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit.....	6
3. Informacion mbi Investimet financiare të shoqërive të sigurimit	10
B. Tregu i Kapitaleve	12
1. Tregu me pakicë	12
2. Bursa Shqiptare e Titujve	13
3. Obligacionet me ofertë private	14
C. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve.....	15
II. Përfundime	17

I. Hyrje

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare” në muajin prill të vitit 2017, ku angazhohen të ndër marrin veprime për të ulur nivelin e përdorimit të monedhave të huaja në ekonomi sipas sektorëve të cilët mbikëqyrin, monitorojnë apo operojnë në aktivitetin e tyre.

Duke qenë se në vendin tonë është krijuar një traditë e përdorimit të gjerë të monedhave të huaja (valutat), kryesisht të Euros dhe dollarit amerikan, masat që duhet të ndërmerren për minimizimin e përdorimit të monedhave të huaja duhet të jenë të kujdesshme dhe të argumentuara, për të qenë efektive.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (më tej, Autoriteti) monitoron me kujdes përdorimin e monedhave të huaja në tregjet financiare nën mbikëqyrje. Lidhur me veprimtarinë në valutë, në këtë raport janë përfshirë:

Informacion për tregun e sigurimeve sipas produkteve dhe investimeve nga shoqëritë, informacion për fondet e investimeve dhe të pensioneve vullnetare private. Disa nga produktet financiare të këtyre institucioneve, operojnë në valutë për arsye objektive.

Të tillë janë, për shembull disa produkte të sigurimit të detyrueshëm motorik, si polica kufitare dhe kartoni jeshil. Produkti i Kartonit Jeshil është produkt ndërkombëtar sigurimi, i cili lëshohet në monedhën Euro, pasi edhe detyrimet që i linden shoqërisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për pagesë dëmshpërblimi nga ky sigurim janë në Euro. Polica kufitare lëshohet në pikat e kalimit kufitar gjatë hyrjes së automjeteve me targa të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pagesa e primit të policës në monedhën vendase do të vështirësonte procesin e pajisjes së konsumatorit me këtë policë sigurimi. Po kështu, disa nga produktet kryesore të aktivitetit të sigurimit, si sigurimi i pronës me përfitues bankat tregtare ose sigurimi i Jetës së debitorit, janë të lidhura ngushtësisht me monedhën e kredisë. Monedha në të cilën disbursohet kredia dikton dhe monedhën e lëshimit të policës, për shkak të nevojës për të rikuperuar në të njëjtën monedhë vlerën e detyrimit, në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Tek fondet e investimit, në disa prej tyre, natyra e profilit të veprimtarisë kërkon investimin e tyre në aksione apo tituj të tregjeve ndërkombëtare, pra realizohet në valutë. Gjatë vitit 2022 vihet re një rënie e aseteve neto të fondeve të investimit në monedhë të huaj.

II. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve

A. Tregu i sigurimeve

1. Informacion mbi primet e shkruara bruto

Referuar të dhënave për 31.12.2022, primet e shkruara bruto për të gjithë aktivitetin e tregut të sigurimeve Jo-Jetë dhe Jetë rezultojnë në rreth 21.03 miliardë lekë. Rreth 31.9% e tyre është realizuar në monedhën Euro.

Në mënyrë të detajuar, vihet re se përveç produkteve të detyrueshme të Kartonit Jeshil dhe Sigurimi Kufitar, ka edhe disa produkte vullnetare që rezultojnë me të ardhura pothuajse 100% të realizuara në Euro, siç është Sigurimi i kombinuar i Aksidenteve personale dhe shëndetit, Sigurimi i Jetës në Udhëtim dhe Sigurimi i Jetës së Studentit. Gjithashtu, produktet që shfaqin një vlerë të primeve të shkruara në përqindje të lartë në Euro janë: Sigurimi Kasko, Sigurimi i të Gjitha Risqeve në Montim (EAR)¹ në aktivitetin e sigurimit Jo-Jetë dhe Sigurimi i Jetës me Kursim dhe “Flexi Plan”² për Sigurimin e Jetës. Ndërkohë, produktet si Sigurimi i Mallit në Transport apo Sigurimet Inxhinierike paraqesin një nivel të lartë Euroizimi për shkak të interesit të siguruar nga këto kontrata, interes i cili vlerësohet kryesisht në Euro në rastet e import-eksporteve dhe sigurimeve inxhinierike që përfshijnë vepra madhore të infrastrukturës, përfshirë ato me shoqëri ndërkombëtare.


Referuar grafikut 1, në 31.12.2022 pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt totalit për aktivitetin e Sigurimit Jo-Jetë ka pësuar rritje me rreth 2.3% krahasuar me fundvitin 2021, duke shkuar në 32% nga 29.7%. Edhe pse brenda strukturës së klasave të sigurimit ka patur disa ndryshime krahasuar me periudhën e mëparshme, nuk konsatohen ndryshime të theksuara në peshën totale të primeve të shkruara në Euro kundrejt totalit për aktivitetin e Sigurimit Jo-Jetë.

Siç vërehet në grafikun e mëposhtëm, në 31.12.2022, klasat që kanë shfaqur rritjen më të theksuar të primeve të shkruara në Euro në krahasim me 31.12.2021, janë: Sigurimi i Përgjegjësisë Civile me rritje me 11.7% (nga 45.9% në 57.6%), Sigurimet e Mallit në Transport me rritje të peshës me 4.5% (nga 54.4% në 58.9%), Sigurimet Motorike me rritje të peshës me 2.9% (nga 21.6% në 24.5%), Sigurimet e Pronës me rritje të peshës me 1.8% (nga 53.7% në 55.5%), pasuar nga Sigurimet e Aksidenteve e Shëndetit me rritje 1.6% (nga 61.9% në 63.5%). Ndërsa, rënie në peshë të primeve të shkruara në Euro në krahasim me 31.12.2021 janë: Sigurimet e Marinës me rënie të peshës me 4.1% (nga 9.7% në 5.6%), Sigurimet Inxhinierike me rënie të peshës me 3.7% (nga 66.7% në 63%) dhe Sigurimet e Garancisë me rënie të peshës me 2.3% (nga 20.8% në 18.5%).

¹ Produkt Sigurimi Jo-Jetë, i cili ofron mbulimin me sigurim nga të gjitha rreziqet për fazën e montimit të makinerive dhe pajisjeve në objektet industriale.


² Produkt Sigurimi Jete, i cili mbulon humbjen e jetës si pasojë e aksidentit, humbjen e jetës nga faktorë natyrorë, paaftësinë e përhershme të plotë, paaftësinë e përhershme të pjesshme, etj.

Grafik 1: Pesha e primeve të aktivitetit të sigurimit Jo-Jetë në EUR kundrejt totalit



Referuar grafikut të mëposhtëm, në 31.12.2022, pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt primeve të shkruara bruto në total për aktivitetin e Jetës ka shënuar një rënie të lehtë me rreth 2.1%, duke arritur në 31.5%, nga rreth 33.6% që ka qenë në 31.12.2021. Siç vërehet në grafikun e mëposhtëm, në 31.12.2022, klasat që kanë shfaqur rënie më të theksuar të primeve të shkruar në Euro në krahasim me 31.12.2021, janë: Sigurimi i Jetës me elementë të ndryshueshëm, me 35.6% (nga 79.5% në 43.9%), Sigurimi Cash Plan me rënie të peshës me 27.7% (nga 62.8% në 35.1%) dhe Sigurimi i kombinuar i Jetës, me rënie të peshës me 4.9% (nga 31.3% në 26.4%). Ndërkohë paraqitet rritje e lehtë e peshës në euro për: Sigurimin e Jetës në grup, me 2.1% (nga 2.4% në 4.5%) dhe Sigurimin e Jetës së Debitorit me rritje të peshës me 1% (nga 22.8% në 23.8%).

Grafik 2: Peshja e primeve të aktivitetit të sigurimit të Jetës në EUR kundrejt totalit



2. Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit


Depozitat e shoqërive të sigurimit për periudhën 31.12.2022, të investuara në monedhat Lekë dhe valutë të huaj, rezultojnë në vlerë totale rreth 14.2 miliardë Lekë. Nga këto depozita, në monedhën vendase Lekë janë investuar rreth 6.9 miliardë Lekë, ose rreth 48.5% e totalit të depozitave, ndërsa ato në valutë rezultojnë të jenë rreth 7.3 miliardë Lekë, ose rreth 51.5% e vlerës totale të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat zënë rreth 90.5% të depozitave totale në valutë dhe 46.6% të depozitave totale (lekë + valutë), pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Kundrejt fundit të vitit 2021, depozitat në valutë edhe pse me rritje prej 0.7 miliardë lekë, shënojnë një rënie në peshë ndaj totalit të depozitave të shoqërive të sigurimit. Kjo rënie vjen si pasojë edhe e rënies së kursit të këmbimit të Euros i cili ka rënë nga 120.76 në vitin 2021, në 114.23 në 2022.


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2021	31.12.2022
Tregu Total	6,222	6,912	610	693	6,036	6,632

Grafik 3: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve në total



Grafik 4: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave



a) Tregu i sigurimeve Jo-Jetë


Përsa i përket tregut të sigurimit Jo-Jetë, për periudhën 31.12.2022, janë investuar 5.3 miliardë Lekë në depozita në Lekë, ose rreth 45% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa rreth 6.3 miliardë Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose rreth 55% kundrejt totalit të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat kapin vlerën rreth 50.2 milionë Euro, ose kundravlerën rreth 5.7 miliardë Lekë. Depozitat e investuara në Euro zënë rreth 91% të depozitave totale në valutë dhe 49.6% të depozitave totale, pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Kundrejt fundit të vitit 2021, depozitat në valutë kanë shënuar rënie ndaj totalit të depozitave me 0.5%. Gjithashtu peshja e depozitave në Euro ndaj totalit të depozitave ka rënë me 0.6%, kjo jo vetëm si efekt i rënies së kursit të këmbimit të monedhës Euro kundrejt Lekut, por edhe si pasojë e shtimit të depozitave në Lekë. Ndërsa peshja e depozitave në Euro ndaj depozitave në valutë është pakësuar me 0.3%.


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2021	31.12.2022
Tregu Jo-Jetë	4,622	5,259	499	573	5,157	5,729

Grafik 5: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve Jo-Jetë



Grafik 6: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave



b) Tregu i sigurimeve të Jetës


Përsa i përket tregut të sigurimit të Jetës, rreth 1.7 miliardë Lekë janë investuar në depozita në Lekë, ose 61.8% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa rreth 1 miliardë Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose 38.2% kundrejt totalit të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat arrijnë vlerën rreth 7.9 milionë Euro, ose kundravlerën rreth 0.9 miliardë Lekë. Depozitat në Euro zënë rreth 88.3% të depozitave në valutë dhe 33.8% të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Raporti i depozitave në valutë me depozitat totale, nuk ka pësuar ndryshim në krahasim me fundin e vitit 2021.


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2021	31.12.2022
Tregu Jetë	1,601	1,653	111	120	879	903

Grafik 7: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve të jetës



Grafik 8: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave




3. Informacion mbi Investimet financiare të shoqërive të sigurimit

Investimet financiare të shoqërive të sigurimit për periudhën 31.12.2022, konsistojnë kryesisht në:


- Bono Thesari në Lekë, në vlerën 297.6 milionë Lekë, nga të cilat 255.6 milionë janë investuar nga shoqëritë e jo-jetës dhe 42 milionë Lekë nga shoqëritë e jetës. Në krahasim me 31.12.2021 kemi një rritje prej 62 milionë lekë ose rreth 26.3%.
- Obligacione në Lekë, në vlerën 4.1 miliardë Lekë, nga të cilat rreth 2.9 miliardë janë investuar nga shoqëritë e jo-jetës dhe 1.1 miliard Lekë nga shoqëritë e jetës. Këto investime janë rritur me 277.5 milionë Lekë gjatë vitit 2022. Gjithashtu, shoqëritë e tregut të sigurimeve kanë investuar dhe në obligacione në Euro, në vlerën 7.2 milionë Euro duke reflektuar një rritje krahasuar me fundvitin 2021, me rreth 1.1 milionë euro.
- Kuota në fonde investimesh në Lekë, në vlerën 146.5 milionë Lekë, nga të cilat 122 milionë Lekë janë investuar nga shoqëritë e jo-jetës dhe 24.5 milionë lekë nga shoqëritë e jetës. Këto investime kanë pasur një rritje me 20.5 milionë Lekë gjatë vitit 2022. Gjithashtu gjatë vitit 2022 janë investuar nga shoqëritë e jo-jetës rreth 0.28 milionë Euro.

Investimet financiare në valutë në 31.12.2022 janë të gjitha në monedhën Euro dhe përbëjnë rreth 16% të totalit të investimeve financiare. Gjatë vitit 2022 vihet re një rritje e lehtë e investimeve financiare në monedhën Euro nga 15% në 16%.

Grafik 9: Investimet financiare në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të investimeve financiare



Grafik 10: Pesha e Investimet financiare në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të Investimet financiare




B. Tregu i Kapitaleve

Tregu Shqiptar i Kapitaleve, i mbizotëruar nga titujt e borxhit të qeverisë që janë kryesisht në lekë, karakterizohet nga një shkallë tepër e ulët e euroizimit. Pjesëmarrësit kryesorë në këtë treg përdorin kryesisht monedhën vendase. Megjithatë ka edhe emëtues privatë të titujve që kanë kryer emëtime në valutë. Autoriteti monitoron këtë treg, për të vlerësuar ecurinë e treguesve dhe nevojën për masa specifike.


1. Tregu me pakicë

Të dhënat e tregut me pakicë përfshijnë tregtimin e titujve të borxhit të qeverisë mes shoqërive komisionere/bankave të licencuara dhe investitorëve individuale apo personave juridikë, në lekë dhe monedhën Euro. Tregu me pakicë dominohet nga blerjet në tregun primar për llogari të investitorëve. Në krahasim me vitin 2021, vihet re se transaksionet në valutë janë rritur gjatë vitit 2022: nga 0.04% transaksione në valutë ndaj totalit në fund të vitit 2021, në 1.20% transaksione në valutë ndaj totalit në fund të vitit 2022.

Grafik 9: Tregu me Pakicë i titujve Qeveritare




Grafik 10: Tregu me Pakicë i titujve Qeveritare në %



2. Bursa Shqiptare e Titujve

Në Bursën Shqiptare të Titujve (ALSE), edhe gjatë vitit 2022 janë realizuar vetëm transaksione në tituj të Qeverisë Shqiptare, të nominuar në lekë.


Grafik 11: Pesha e transaksioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të transaksioneve




3. Obligacionet me ofertë private

Tregu i kapitaleve iu ofron shoqërive aksionare mundësi për sigurimin e fondeve për financimin e biznesit e tyre. Duke filluar nga dhjetori 2011, emetimi i obligacioneve nëpërmjet ofertave private ka qenë një burim financimi për banka, institucione financiare dhe shoqëri tregtare. Obligacionet janë emëtuar në monedhën vendase dhe në valutë të huaj (EUR dhe USD). Totali i shumës së pashlyer të obligacioneve të emëtuar nëpërmjet ofertave private në fund të vitit 2022 është: 14,068 milionë lekë, nga të cilat 55.21 % janë në euro (ekuivalenti në lekë 7,766 milionë) dhe 4.88 % në USD (ekuivalenti në lekë 686 milionë). Gjatë vitit 2022 vihet re një rritje e obligacioneve me ofertë private të emetuara në valutë.

Grafik 12: Obligacionet me ofertë private të emetuara dhe të pashlyera



Grafik 13: Pesha e obligacioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të obligacioneve me ofertë private të emtuara dhe të pashlyera



C. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve



Në 31.12.2022, në tregun e fondeve të investimit operuan njëmbëdhjetë fonde të hapura me ofertë publike, gjashtë nga të cilët kryejnë aktivitetin në valutë të huaj, kryesisht në Euro. Fondet e tjera të investimit kryejnë veprimtarinë në monedhën vendase Lekë.

Asetet neto të fondeve, të cilët kryejnë aktivitetin e tyre në valutë të huaj, janë rreth 42 mln Euro (4.787 miliardë lekë) dhe zënë rreth 11.54% të totalit të aseteve neto të tregut. Edhe detyrimet e fondeve që mbahen në valutë të huaj, të cilat përfaqësojnë detyrimet ndaj shoqërisë administruese për tarifën e administrimit, ndaj bankës depozitare dhe detyrime për pagesat ndaj kuotambajtësit, zënë rreth 9.09% të detyrimeve të tregut.

Asetet neto të fondeve të tjera të investimit, asetet dhe detyrimet e të cilave mbahen në monedhën vendase lekë, janë rreth 36.7 miliardë Lekë dhe zënë rreth 88.46% të totalit të aseteve neto të tregut.

Gjatë vitit 2022, vlera e aseteve neto të fondeve në valutë ka pësuar rënie në krahasim me fundvitin 2021 me 47.26%, ndërkohë që pesha specifike që këto fonde zënë ndaj totalit të aseteve neto të tregut të fondeve të investimit ka pësuar një rënie të lehtë nga 11.68% në fundvit 2021 në 11.54% në fundvit 2022.

Grafik 14: Vlera Neto e Aseteve të fondeve të investimit



Sa i përket fondeve të pensioneve vullnetare, ato e kryejnë tërësisht aktivitetin e tyre në lekë.

II. Përfundime

Pesha e vlerës së aseteve që administrohen prej subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti është relativisht e ulët. Gjithashtu, bazuar në të dhënat e mësipërme, niveli aktual i përdorimit të valutës (Euro) në tregjet e mbikëqyrura nga AMF është në nivele përgjithësisht të ulta dhe i diktuar nga profili i veprimtarisë së institucioneve të mbikëqyrura.

Autoriteti do të monitorojë zhvillimet në këto tregje dhe më konkretisht do të fokusohet në drejtim të rritjes së transparencës për produktet që iu ofrohen *investitorëve*, veçanërisht në drejtim të evidentimit dhe kuptimit sa më të qartë të rrezikut (të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) të kursit të këmbimit.